



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**



**VENDIM**

**Nr.15, datë 13/06/2019**

**MBI**

**“MIRATIMIN E TARIFAVE, TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, PËR  
STUDENTËT MBETËS DHE PËRSËRITËS, NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT  
TË ARTEVE”**

Mbështetur në pikën 3, shkronja ç të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit të ciklit të parë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016” (i ndryshuar); nenin 22 të “Rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, Master Shkencor dhe Master i Arteve në Universitetin e Arteve”; Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve nr. 20, datë 29.05.2019 “Mbi propozimin për miratimin e tarifave, të ciklit të dytë të studimeve, për studentët mbetës dhe përsëritës, në Fakultetet e Universitetit të Arteve”; shkresën e Sektorit Mësimor me nr. 724/1 prot., datë 25.05.2019, shkresën e Departamentit KMDP të Fakultetit të Muzikës me nr. 180/1 prot., datë 21.05.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 724/1 prot., date 22.05.2019), shkresën e Fakultetit të Artit Skenik datë 23.05.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 760 prot., datë 23.05.2019), pasi e diskutoi me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e tarifave, të ciklit të dytë të studimeve, për studentët mbetës dhe përsëritës, në Fakultetet e Universitetit të Arteve, sipas propozimit të Senatit Akademik.
2. Deri në daljen e akteve të tjera rregullatore mbi këtë përcaktim, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen student mbetës, nuk paguajnë tarifë për kredit për lëndët përsëritëse. Studentët që konsiderohen përsëritës do e ripaguajnë tarifën e shkollimit.
3. Mbi kohëzgjatjen normale të shkollimit, studentët mbetës do të paguajnë tarifën për kredit.

